



Datë: 07.07.2025
Numër Protokolli: 4651/2025

A.nr.907/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Eshref Shabani kryetar Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 907/2025 të datës 19.05.2025, të parashtruar nga ankuesja K.D, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, në çështjen juridike “ kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa, A.nr.907/2025 e datës 19.05.2025, e parashtruar nga ankuesja K.D.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 708, i datës 02.05.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, K.D, (tutje referuar vetëm ankuese), me datë 19.05.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër protokolli 708, të datës 02.05.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 30.05.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3245/2025 të datës 19.05.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë me numër protokolli 503, e datës 18.04.2025; Vendimi me

numër protokolli 708, i datës 02.05.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesen; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2025, dërguar përmes emailit nga R.K, për F.K; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 907/2025, e datës 30.05.2025; Akt Emërimi me numër protokolli 03-112-1457, i datës 31.12.2012, për ankuesen; Lista e pagave e muajit qershor e vitit 2023; Lista e pagave për muajin shkurt e vitit 2024.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses të përcaktuar si në dispozitivin e këtij vendimi është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas Akt Emërimit 03-112-1457 të datës 31.12.2012, mban pozitën e punës “ Drejtoresh e Departamentit të Auditimit të Brendshëm”.

Ankuesja me datën 18.04.2025, i është drejtuar Drejtorit të Njesisë për Burime Njerëzore, të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kërkesën për kompensimin e shtesës e përvojës së punës mbi pagën bazë prej 0.5% se sipas Aktgjykimit Nr.KO79/23, me referencë AGJ2316/24, të datës 23.01.2024, është konstatuar sipas nenit 6, të ligjit të kontestuar është shpallur i pavlefshëm, dhe se ky paragraf lidhet me shtesat mbi pagën për përvojën e punës dhe në përputhje me nenin 45, paragrafi 1 të po njëjtë ligj është shfuqizuar edhe Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përmes nenit 18 të Ligjit ku specifikohet se “Për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil, ndërsa e drejta e fituar sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej 0,5%.” në pagën bazë për gjdo vit të përvojës së punës bazuar në parimin e sigurisë juridike dhe vazhdueshmërisë së drejtave të fituara.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstatoi se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariati të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 02.05.2024, me numër protokolli 708, ankueses i ka refuzuar kërkesës si të pabazuar me arsyetimin se kërkesa për shtesë të 0.5%, të përvojës së punës duhet të refuzohet për shkak të mungesës së një bazë ligjore që do të mundësonte realizimin e saj, se me aktgjykimin Nr.KO79/23, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ka shpallur jo kushtetues dispozitat e Ligjit për paga, përfshirë ato që parashikonin për përvojën e punës, dhe se në përputhje me aktgjykimin Nr.KO79/23, të datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe duke marr parasysh mungesën e një bazë ligjore, për realizimin e shtesës prej të 0.5%, për përvojën e punës kërkesa duhet të refuzohet, dhe se ky vendim mbetet në fuqi, deri sa Kuvendi të miratojë ndryshimet e nevojshme ligjore përkatëse.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundërshton vendimin me numër protokolli me numër protokolli 708, të datës 02.05.2025, të Drejtorit të Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke pretenduar se arsyetimit të vendimit i mungon baza ligjore, nuk qëndron për arsye se kërkesa ime është në përputhje të plotë me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.KO79/23, të datës 23.01.2024, i cili shpall jo kushtetues dispozitat e Ligjit për Paga, përfshirë edhe ato që parashikonin kufizimin e shtesës për përvojën e punës për 15, vitet e para me vetëm 0.25%. dhe se bazua në këtë aktgjykim me takon që përvoja e punës për 15, vite e para të llogaritet me 0.5 %, të pagës bazë dhe jo me 0.25% siç ka aplikuar Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe se vlera e kësaj shtesë është 39.84, €, ndërsa demë financiar i shkaktuar nga janari i vitit 2023, deri në mars 2025, arrin shumën prej 1075.68 €, me tej ankuesja ka pretenduar që Këshilli të shfuqizoje vendimin me numër protokolli 708, të datës 02.05.2025, të Drejtorit të Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të aprovojë në tersi kërkesën me numër protokolli 01/504, të datës 18.04.2025, dhe se ankueses ti behet

kompensimi i plotë financiar për periudhën nga janari i vitit 2023, deri në mars 2025, arrin shumën prej 1075.68 €.

Lidhur me pretendimin e ankueses për kompensimin përvojës së punës, Kolegji i Këshillit, konstaton se me nenin 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është përcaktuar: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, mirëpo duke marr parasysh që disa nene të këtij ligji kanë qenë të kontestuar pranë Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij, Gjykata Kushtetuese e Kosovës përmes Aktgjykimit për rastin nr.K079/2023, në nenin 380 të këtij aktgjykimi, konstaton se paragrafi 6 i nenit 6 të Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit sepse përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës, me pikën 381 të këtij aktgjykimin thuhet se sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa me pikën 382 të këtij aktgjykim theksohet se lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë për qind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.” rrjedhimisht duke marr parasysh dispozitivin e këtij aktgjykimi ku sipas pikës III përcaktohet TË KONSTATOJË se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga baze) të Ligjit nr.08/L-196 për Pagat ne Sektorin Publik, nuk është ne përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 te nenit 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotja e pronës) te Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa sipas pikën VIII është përcaktuar TË URDHËROJË, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, Kuvendin e Republikës së Kosovës, qe brenda gjashte (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafit 6 te nenit 6 (Paga baze) të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat ne Sektorin Publik, ne pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim”, andaj përkitazi me këtë dhe duke marr parasysh faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk ka ndërmarr veprimet konform aktgjykimit të cekur si më lartë, gjegjësisht nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se pa u bërë ky plotësim ndryshim nuk mund të obligoj institucionet që të bëjnë këtë kompensim, e për rrjedhojë në këtë fazë të procedurës nuk është e mundur që pretendimi i ankueses të konsiderohet si i bazuar.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.907/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses K.D;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Sekretarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.